



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Ured Generalnog Sekretara - Office of the General Secretary

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore - Jedinica za upravljanje ljudskim resursima
Human Resources Management Unit

Datë: 29.01.2025

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Shëndetësisë, në koordinim me Komisionin e Pranimin, si dhe bazuar në nenin 47, paragrafin 11, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (Gazeta Zyrtare Nr. 21, 18 shtator 2023) dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 Për procedurën e pranimin në shërbimin civil, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I.** Përfundon procedura e rekrutimit me nr. ref. RN00015910, e shpallur më 02.12.2024, për pozitën Kryeinspektor Shëndetësor
- II.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Procedura e rekrutimit me nr. ref. RN00015910, e shpallur më 02.12.2024, për pozitën Kryeinspektor Shëndetësor, përfundon për shkak se asnjëri nga dy kandidatët e kualifikuar për testimin me shkrim, sipas verifikimit paraprak të aplikacioneve, nuk ka marrë pjesë në testin me shkrim, i cili ishte planifikuar të mbahej më 29.01.2025, nga ora 10:00.

Kandidatët janë njoftuar në mënyrë të rregullt për testimin me shkrim dhe kanë konfirmuar marrjen e njoftimit. Komisioni i Pranimin ka filluar punën nga ora 09:00, duke përgatitur pyetjet e testit me shkrim, dhe pas orës 10:00 ka pritur për më shumë se 45 minuta. Megjithatë, asnjëri prej kandidatëve nuk është paraqitur në testin me shkrim.

Bazuar në nenin 47, paragrafin 11, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nëse procedura e rekrutimit përfundon pa të paktën dy (2) kandidatë fitues, të cilët kanë kaluar pragun minimal prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, atëherë procesi i rekrutimit ndërpritet dhe organizohet një procedurë e re e rekrutimit.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim, mund të ushtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, në afatin prej 30 ditësh prej marrjes së këtij vendimi.

Haki Smajli

Udhëheqës i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve

Vendimi i dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit të Pranimit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Arkivit të MSh-së.*

